URDHËR
Nr. 35, datë 14.1.2025

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Arian Jaupllari, nga data 16.1.2025 deri më datë 19.1.2025.

2. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) Ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) Bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë tek një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

4. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri, z. Arian Jaupllari.

5. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

6. Ky urdhër hartohet në 3 (tre) kopje të njëjta: 1 (një) për arkiv/protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj